



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

NJESIA E PROKURIMIT

Data: 03.11.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion i qendres se moshes se trete prane Pallatit te kultures,Qyteti i Peshkopise, Bashkia Diber.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pune ndertimi (45000000-7).

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.271.684 (Nje milion e dyqind e shtatedhjete e nje mije e gjashteqind e tetedhjete e kater) leke **pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78,pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor BASHKIA DIBER ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

c. Formular i ofertes.

d. Lista e cmimeve sipas zerave te preventivit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve të Nr.10091 date 05.03.2009.), ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros minimale vjetore duhet te jete jo me pak se **40 %** të vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitet për vitin 2021, 2022 dhe 2023 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore

Shënim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Kjo bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislationit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit te kontrates qe prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

1. N.P – 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
2. N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
3. N.S– 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
4. N.S – 18 A Punime topogjeodezike.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur ne SPE.

2.3.3 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar per keto punime.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të pakten periudhën **Korrik 2022- Shtator 2023**

Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë noteriale pune.

Shënim: Per kete pike 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Drejtues teknik jane kerkuar baze te punimeve qe do te kryhen per kete procedure, dhe jane ne propocion me te gjithë zerat e punimeve te preventivit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **5 (Pese) punonjës.**

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2022- Shtator 2023.**

Shenim: Per kete pike 2.2.4. te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate dhe ne baze te shperndarjes se punimeve ne te gjithe teritorin e Bashkise Diber.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, te pakten si me poshte:

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (Nje) punonjes **Bojaxhinj** , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten muajin muajin (**Korrik 2023**) e ne vazhdim.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (Nje) punonjes **hidraulik** , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten muajin muajin (**Korrik 2023**) e ne vazhdim.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2** (Dy) punonjes **murator** , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten muajin muajin (**Korrik 2023**) e ne vazhdim.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (Nje) punonjes **pllaka shtrues** , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten muajin muajin (**Korrik 2023**) e ne vazhdim.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1** (Nje) punonjes **elektricit**, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per te pakten muajin muajin (**Korrik 2023**) e ne vazhdim.
- Per specialistet e sipercituar sipas profesioneve, duhet te paraqiten deshmitet/certifikatat ose cdo dokument tjeter qe verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale te punes te vlefshme.
- Specialistet e sipercituar sipas profesioneve, duhet te jene te pajisur gjithashtu edhe me kartela personale te sigurimit teknik te vlefshme, te leshuara nga organe kompetente ne bazet e Ligjit Nr.8734, date 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.
- Secili specialiste i sipercituar sipas profesioneve, duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per te pakten muajin (**Korrik 2023**) e ne vazhdim.

Shenim: Per kete pike 2.3.5 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikës 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertës, te dorëzuara ne rrugë elektronike . Këto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Ne bazet e pikës 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohe qe operatorët ekonomikë te dëshmojnë qe kanë personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet te paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise (te vlefshme) "ose ekuivalent;

- Iso 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurise ne pune” (te vlefshme) ose ekuivalent.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Çertifikat e siperpermendura jane kerkuar nga ana e AK qe operoret ekonomik duhet te jene te certifikuar per cilesin e punimeve, per sigurine ne pune dhe mbi cilesine e saldimit, ku jane te lidhura ngushte me objektin qe prokurohet.*

2.3.7 Operoret ekonomik duhet te paraqesin mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (shtojces 8):

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamioncina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1

Operoret ekonomik qe disponojne kontrate furnizimi per Fabrike asfalti-betoni e pajisur dhe Nyje thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kerkohet personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

- Kokore, minimumi 5 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat

vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Shenim: Per kete pike 2.3.7 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga projektuesi.

2.3.8. Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT